

VENDIM
Nr. 13, datë 10.3.2016

PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË VAZHDIM, TË GRANTIT TË ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.19, DATË 16.3.2015, DHE VENDIMIN NR. 28, DATË 29.5.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2014-2015, për grantin e arsimit, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2015-2016, për grantin e arsimit, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhej vendimit nr.19, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për thirrjen e dytë për nënprogramin e arsimit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 11, datë 25.2.2015”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhej vendimit nr.28, datë 29.5.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin e arsimit, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2015”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve me cikël financimi 2014-2015, të financuara përmes grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi buxhetor	Vlera e Projektit (në Lekë)	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)
1	Bashkia Tirane	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme " Qemal Stafa", Njësia 10	09230	199,189,198	152,297,454	72,297,454	80,000,000
2	Bashkia Diber	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare dhe ndertim palester Radomire, komuna Kala e Dodes	09120	42,616,229	38,042,570	35,054,783	2,987,787
Totali				241,805,427	190,340,024	107,352,237	82,987,787

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe korrekton vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
3. "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e realizuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
4. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së realizuar për vitin 2015.

Tabela 2. Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, përmes grantit të arsimit, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Programi buxhetor	Vlera e Projektit (në Lekë)	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e realizuar në vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)
1	Bashkia Tiranë	Liceu Artistik "Jordan Misja", Tiranë	09230	84,746,629		0	84,746,629
2	Bashkia Tiranë	Rikualifikim i terrenit sportiv në shkollën "Petro Nini Luarasi"	09230	25,000,000		0	25,000,000
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar "Caush Senja" Tunjë, Komuna Tunjë	09231	6,494,161	4,541,584	0	4,541,584
TOTALI				116,240,790	4,541,584	0	114,288,213

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
3. "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
4. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së realizuar për vitin 2015.

Tabela 3. Ndryshim tabelën 1, që i bashkëlidhej vendimit nr.19, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.6, si më poshtë vijon, në tabelën 1 të këtij vendimi i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i shkollës së mesme, Farkë e Madhe, Tiranë, Komuna Farkë	252,467,380	125,701,776	126,765,530

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr.982/1 prot, datë 04.02.2016.
2. Totali i vlerës së projektit si dhe vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.19, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë)
	TOTALI		142,850,074	71,425,039	71,425,035

3. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi ndryshon, nga 6 projekte bëhet 5 projekte.

Tabela 4. Ndryshim në tabelën 1 që i bashkëlidhej vendimit nr.28, datë 29.5.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Për projektin “Rikonstruksioni i Shkollës “Koreografike”, Tiranë”, me vlerë projekti 69,748,393 Lekë, financuar përmes grantit të Arsimit, sipas vendimit nr. 28, datë 29.05.2015 “Për shpërndarjen e fondit për programin e arsimit, pjesë e fondit për zhvillimin e rajoneve, për vitin 2015”, Tabela 1, pika 5 e shënimit, i delegohet e drejta për aplikim për financim, Bashkisë së Tiranës, si institucioni përgjegjës që administron objektet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Propozimi për delegimin e kësaj të drejte, bëhet nga sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas shkresës me nr.982/2 Prot, datë 25.2.2016.